

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.Br.72 /017	Data: Datum: 03.03.2017	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenet: 77, 84 dhe 87 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-9342 të datës 02.03.2017 të parashtruar nga Bedri Ademaj, nga fshati Lubovë, Komuna e Istogut, për përkrahje furnizim me karburant , dhe nxjerri:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-9342 të datës 02.03.2017 të parashtruar nga Bedri Ademaj, nga fshati Lubovë dhe i lejohet furnizimi i automjetit me nga 57 litra karburant për muaj, për dërgimin e nënës Ajmane Ademaj për dializë në Pejë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurin me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Bedri Ademaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-9342 të datës 02.03.2017 me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin benë transportimin e nënës Ajmane Ademaj për dializë në Pejë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Ajmane Ademaj, është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për dializë.

Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Istog nuk ka mundësi që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant. Shefi autoparkut do të pajisë të lartpërmendurën më vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Bedri Ademaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyres së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Elaki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.Br.73 /017	Data: Datum: 06.03.2017	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenet: 77, 84 dhe 87 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-8606 të datës 27.02.2017 të parashtruar nga Gjyla Blakaj, nga fshati Llukac i Begut, Komuna e Istogut, për përkrahje furnizim me karburant , dhe nxjerri:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-8606 të datës 27.02.2017 të parashtruar nga Gjyla Blakaj, nga fshati Llukac i Begut, dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 120 litra karburant, për dërgimin e nënës Gjyla Blakaj për rrezatime në Prishtinë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurin me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Gjyla Blakaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-8606 të datës 27.02.2017 me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin benë transportimin e nënës Gjyla Blakaj për rrezatime në Prishtinë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Gjyla Blakaj, është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për rrezatime në Prishtinë .

Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Istog nuk ka mundësi që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant. Shefi autoparkut do të pajisë të lartpërmendurën më vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Gjyla Blakaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkhiv të Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.Br.79 /017	Data: Datum: 09.03.2017	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenet: 77, 84 dhe 87 të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-7599 të datës 21.02.2017 të parashtruar nga Rrahime Lipaj, nga fshati Sudenicë, Komuna e Istogut, për përkrahje furnizim me karburant , dhe nxjerri:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa kërkesën Nr.06-553-7599 të datës 21.02.2017 të parashtruar nga Rrahime Lipaj, nga fshati Sudenicë, dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 280 litra karburant, për dërgimin e Rrahime Lipaj, për 28 seanca rrezatime në Prishtinë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurin me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Rrahime Lipaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-7599 të datës 21.02.2017 me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin benë transportimin e Rrahimes për 28 seanca rrezatime në Prishtinë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Rrahime Lipaj, është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për rrezatime në Prishtinë .

Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Istog nuk ka mundësi që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant. Shefi autoparkut do të pajisë të lartpërmendurën më vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Rrahime Lipaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-81/017	Data: Datum: 14.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 77, 84. dhe 87. të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2007), nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/010, dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën Nr.01-400-9154 të datës 01.03.2017 e parashtruar nga Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve "Teuta" me seli në Komunën e Pejës, për përkrahje financiare për realizimin e projektit manifestimi letrar tre kufitar "Muzat e Alpeve" dhe nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: Nr.01-400-9154 të datës 01.03.2017 e parashtruar nga Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve "Teuta", për përkrahje financiare për realizimin e projektit manifestimi letrar tre kufitar "Muzat e Alpeve" dhe i ndahen 530.00€ (pesëqind e tridhjetë euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transvere nga programi buxhetor i kulturës në Drejtorinë për Arsim.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Teuta", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim.
4. Me kopje të këtij Vendim njoftohen: Ajete Beqiraj, Drejtoria për Arsim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.92/17	Data: 16.03.2017	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), me qëllim të verifikimit në terren të të gjitha kërkesave të parashtruara për ndërtimin e shtëpive, sipas projektit: "Ndërtimi i shtëpive për familje të pastrehë", projekt i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, bie këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për verifikimin dhe grumbullimin e fakteve në terren të të gjithë parashtruesve të kërkesave që kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive dhe në komision caktohen:
 - 1) Naser Gjocaj, Zyrtarë për Hapësirë Publike dhe Eficiencë të energjisë, kryesues;
 - 2) Elfete Blakaj, Përgjegjëse për mjedis, anëtare;
 - 3) Rustem Gashi, Zyrtar për planifikim hapësinor dhe ndërtim, anëtar;
 - 4) Mahije Hysenaj, Nëpunëse administrative financiare, anëtare dhe
 - 5) Daut Bujupaj, Zyrtar i lartë për planifikim, mbrojtje dhe shpëtim, anëtar.
2. Komisioni i cekur më lartë do të shqyrtojë të gjitha kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive; do të dali në vend të ngjarjes në terren për të verifikuar gjendjen faktike të çdo parashtruesi të kërkesës, duke grumbulluar fakte dhe material tjetër të nevojshëm lidhur me gjendjen e që do t'i shërbejnë Komisionit për përzgjedhje të skamnorëve; do të bëjë hartimin e listës së familjeve në nevojë dhe skamnore të cilat nuk kanë të zgjedhur çështjen e banimit dhe të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara; do të njoftojë Kryetarin me listën e familjarëve të verifikuar; si dhe do t'i kryejë edhe punët të tjera që rrjedhin nga natyra e punës, rrethanat dhe kushteve momentale.
3. Komisioni i cekur ka karakterin "ad hoc" dhe pas verifikimit të gjendjes në teren të parashtruesve të kërkesave do t'i pushojnë të gjitha obligimet që rrjedhin nga ky Vendim.
4. Të gjitha punët juridiko-administrative dhe teknike për nevoja të grupit punues do t'i kryejë: Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
5. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit dhe Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
6. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e komisionit, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01Nr.93/017	Data: Datum: 20.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në bazë të Ligjit për Pyjet e Kosovës Nr.03/L153 /2010, më qellim të formimit të komisionit, për Regjistrimin e dëmeve në pyjet shoqërore nxjerr:

V E N D I M

- Formohet Komisioni për Regjistrimin e dëmeve në pyjet shoqërore dhe në Komision caktohen:
 - Xhevat Idrizaj, Përgjegjës i njësisë menaxhuese Radush, Kryetar i komisionit
 - Bajram Sejdiqaj, Pylltar i terrenit, anëtar;
 - Rifat Dreshaj, Pylltar i terrenit, anëtare;
- Komisioni obligohet të bëjë Regjistrimin e dëmeve në pyjet shoqërore në të gjitha terrenet; të dhënat duhet të llogariten cung për cung, vëllimi të llogaritet në nalësin e gjoksit; llogaritja duhet të bëhet në tabela unike të llogaritjes së dëmeve të pyjeve; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e punës gjatë regjistrimit të dëmit dhe pas përfundimit kopjen e Regjistrimi të dëmeve do t'ia dorëzojë Kryetarit; do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij komisioni.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: anëtarët e komisionit dhe DBPH.
- Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e komisionit, Drejtoria Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomit dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.Br.95 /017	Data: Datum: 20.03.2017	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 77, 84. dhe 87. të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.08/2007), shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-12455 të datës 20.03.2017 të parashtruar nga Ganimete Podrimaj, nga fshati Carrallukë, Komuna e Istogut, për përkrahje furnizim me karburant , dhe nxjerri:

V E N D I M

1. **MITATOHET:** kërkesa Nr.06-553-12455 të datës 20.03.2017 të parashtruar nga Ganimete Podrimaj, nga fshati Carrallukë, dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 50 litra karburant, për dërgimin e Ganimetes, për 4 seanca çdo tri javë Banjë Prishtinë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurin me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Ganimete Podrimaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-12455 të datës 20.03.2017, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin benë transportimin e Ganimetes për 4 seanca çdo tri javë Banjë-Prishtinë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Ganimete Podrimaj, është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për seanca në Prishtinë .

Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Istog nuk ka mundësi që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant.

Shefi autoparkut do të pajisë të lartpërmendurën më vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ganimete Podrimaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI /PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.107/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 12 të Ligjit Nr.04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe nenit 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet dhe procesverbalin nr.43/17, të datës:20.03.2017 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gjurakoc, lidhur me kërkesën nr.06-553-8507, të datës:27.02.2017, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale-Gjakovë për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Mrika Berisha me vendbanim në fshatin Rakoc, Komuna e Gjakovës, nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa Nr.06-553-8507, e datës: 27.02.2017, parashtruar nga Qendra për punë Sociale-Gjakovë për lejin e strehimit të Mrika Berisha me vendbanim në fshatin Rakoc, Komuna e Gjakovës, në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc.
2. Shtëpia e komunitetit në Gjurakoc është përgjegjëse për përkujdesje ndaj Mrika Berisha gjatë qëndrimit në këtë institucion.
3. Obligohet Organi i kujdestarisë pranë QPS-së, të përgatisë rastin për vendosje, të bartë dosjen në shtëpinë e komunitetit në Gjurakoc dhe të mbikëqyrë gjendjen e të përmendurës në vazhdimësi gjatë qëndrimit në Shtëpinë e personave të moshuar.
4. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Qendra për Punë Sociale-Gjakovë ka parashtruar kërkesën për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Mrika Berisha me vendbanim në fshatin Rakoc, Komuna e Gjakovës.

Bazuar në procesverbalin nr.43, të datës 20.03.2017 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për strehimin e të moshuarve, me të dhënat e paraqitura nga Qendra për punë sociale e Pejës dhe pas shikimit të anamnezës sociale konstatohet se Mrika Berisha ka nevojë dhe i plotëson kriteret për vendosje në shtëpinë e komunitetit në Gjurakoc. Komisioni ka konstatuar se të lartpërmendurës duhet t'i lejohet strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (Komunitetit) në Gjurakoc.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: Mrika Berisha, Qendra për punë sociale -Gjakovë, Lorenc Gegaj-Menaxher i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në aktiven e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI /PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.108/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenin 12 të Ligjit Nr.04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe nenit 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 për punën dhe kriteret e vendosjes së rezidentëve në shtëpinë e personave të moshuar pa përkujdesje familjare dhe në shtëpitë me bazë në komunitet dhe procesverbalit nr.43/17, të datës:20.03.2017 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gjurakoc, lidhur më kërkesën Nr.06-553-9862, të datës:06.03.2017, të parashtruar nga Qendra për Punë Sociale-Klinës për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Feride Kapllanaj me vendbanim në fshatin Gllarevë, Komuna e Klinës, nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa Nr.06-553-9862, datë:06.03.2017, parashtruar nga Qendra për punë Sociale-Klinë për lejin e strehimit të Feride Kapllanaj me vendbanim në fshatin Gllarevë, Komuna e Klinës, në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc.
2. Shtëpia e komunitetit në Gjurakoc është përgjegjëse për përkujdesje ndaj Feride Kapllanaj gjatë qëndrimit në këtë institucion.
3. Obligohet Organi i kujdestarisë pranë QPS-së të përgatisë rastin për vendosje, të bartë dosjen në shtëpinë e komunitetit në Gjurakoc dhe të mbikëqyrë gjendjen e të përmendurës në vazhdimësi gjatë qëndrimit në Shtëpinë e personave të moshuar.
4. Vendimi është përfundimtar.

Arsyetim

Qendra për Punë Sociale-Klinë ka parashtruar kërkesën për lejin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Feride Kapllanaj me vendbanim në fshatin Gllarevë, Komuna e Klinës.

Bazuar në procesverbalin nr.43, të datës: 20.03.2017 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për strehimin e të moshuarve, me të dhënat e paraqitura nga QPS-ja e Pejës dhe pas shikimit të anamnezës sociale konstatoj se Feride Kapllanaj ka nevojë dhe i plotëson kriteret për vendosje në shtëpinë e komunitetit në Gjurakoc. Komisioni ka konstatuar se të lartpërmendurës duhet t'i lejohet strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi njoftohen: Feride Kapllanaj, Qendra për punë sociale-Klinë, Lorenc Gegaj-Menaxher i shtëpisë së komunitetit në Gurakoc dhe një kopje mbetet në aktiven e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr. 109/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), nenit 12 paragrafi 12.3c të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.04/L-081, nenit 6, 7 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 dhe procesverbalit nr.43/17, të datës:20.03.2017 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe pranimin e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Gjurakoc lidhur me kërkesën Nr.01-149/17, të datës: 01.03.2017, e parashtruar nga Organi i Kujdestarisë pranë Qendrës për punë sociale në Deçan për vazhdimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Çeba Alijaj nga Gramaqeli, bie këtë:

V E N D I M

1. I vazhdohet qëndrimi në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc, Çeba Alijaj nga Gramaqeli, Komuna e Deçanit.
2. Shtëpia e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc është përgjegjëse për përkujdesjen ndaj Çeba Alijaj gjatë qëndrimit në këtë institucion.
3. Obligohet Organi i Kujdestarisë të mbikëqyr gjendjen e të përmendurës, e në rast të përmisimit të rrethanave, të bëjë njoftimin me kohë për kthimin në shtëpinë e saj ose vazhdimin e mëtejshëm të qëndrimit në Shtëpinë e personave të moshuar.
4. Ky vendim është përfundimtar.

Arsyetim

Organi i Kujdestarisë pranë Qendrës për punë sociale në Deçan ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e strehimit institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc për Çeba Alijaj nga Gramaqeli.

Udhëheqësi i këtij rasti i caktuar nga Qendra për punë Sociale në Deçan, në përbërje të ekipit të shërbimeve sociale e ka vizituar të përmendurën dhe ka konstatuar që në këtë shtëpitë personave të moshuar nuk i mungon kujdesi i nevojshëm.

Komisioni i Komunës së Istogut, shqyrtoj kërkesën me të dhënat e paraqitura nga Organi i Kujdestarisë pranë Qendrës për punë sociale në Deçan dhe vlerësoj se duhet t'i vazhdohet strehimi institucional në Shtëpinë e personave të moshuar (komunitetit) në Gjurakoc.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim njoftohen: Çeba Alijaj, Qendra për punë sociale-Deçan, Lorenc Gegaj, Menaxher i shtëpisë së komunitetit, Haki Ibrahimaj, Drejtor i Qendrës për punë Sociale-Istog dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.110/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe bazuar në nenet 77, 84. dhe 87. të Ligjit për procedurën administrative (Ligji nr.02/L-28 i Kosovës) dhe në bazë të nenit 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën nr.01-553-10401 të Klubit të Basketbollit "Istogu", në Istog, që ka të bëjë me përkrahje financiare për realizimin e kushteve elementare për basketbollistët e rinj, mori këtë:

V E N D I M

- 1.Ndahen 2500 € (dy mijë e pesëqind euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve të programit buxhetor të kulturës për përkrahje financiare për realizimin e kushteve elementare për basketbollistët e rinj.
- 2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Klubit të Basketbollit "Istogu", në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
- 3.Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorati për Arsim dhe Kulturë.
- 4.Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Klubi i Basketbollit "Istogu", Drejtorati për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.111/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe bazuar në nenet 77, 84. dhe 87. të Ligjit për procedurën administrative (Ligji nr.02/L-28 i Kosovës) dhe në bazë të nenit 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën nr.05-400-8526 të Klubit të Hendbollit "Istogu" (femrat), në Istog, të parashtruar Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, që ka të bëjë me përkrahje financiare për pjesëmarrje në garat e super ligës së Kosovës në hendboll, mori këtë:

V E N D I M

- 1.Ndahen 10.000 € (dhjetë mijë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve të programit buxhetor të kulturës për përkrahje financiare për pjesëmarrje në garat e super ligës së Kosovës në hendboll.
- 2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Klubit të Hendbollit "Istogu" (femrat), në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
- 3.Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorati për Arsim dhe Kulturë.
- 4.Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Klubi i Hendbollit "Istogu" (femrat), Drejtorati për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.112/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe bazuar në nenet 77, 84. dhe 87. të Ligjit për procedurën administrative (Ligji nr.02/L-28 i Kosovës) dhe në bazë të nenit 1 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën nr.05-400-11049 të Klubit Atletik "Olempik" në Istog, të parashtruar Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, që ka të bëjë me përkrahje financiare për nevoja të klubit, mori këtë:

V E N D I M

- 1.Ndahen 1000 € (një mijë euro) nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve të programit buxhetor të kulturës për përkrahje financiare për nevoja të klubit.
- 2.Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Klubit Atletik "Olempik" në Istog, në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
- 3.Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorati për Arsim dhe Kulturë.
- 4.Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Klubi i Atletik "Olempik" në Istog, Drejtorati për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.


 Kryetari i Komunës
 Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr. 113/17	Data: 23.03.2017	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 5 pika d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 , neni 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ i MASHT Nr.08/2014 Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues dhe në bazë të Rekomandimit të Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë: 05Nr.87/17, të datës: 22.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

1. Ju vazhdoen kontratat e punës drejtorëve të institucioneve arsimore si në vijim:
 - 1) znj.Drita Ferati, Drejtoreshë e Shkollës mesme teknike "Mithat Frasheri", në Gurakoc, nga data: 22.03.2017 i vazhdohet kontrata e punës edhe për 4 (katër) vite dhe
 - 2) z.Ymer Lajçi, Drejtor në Gjimnazin "Haxhi Zeka", në Istog, për shkak të daljes në pension i vazhdohet kontrata e punës deri më datë: 05.10.2017.
2. Obligohet Drejtorati për Arsim dhe Kulturë që Drejtorëve të cekur në pikën 1. të ju vazhdoj kontratat e punës në pajtim me procedurat e përcaktuara në Udhëzimet administrative.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të të njëjtit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtorati për Arsim dhe Kulturë.
4. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Drejtorët e cekur në këtë Vendim, Drejtorati për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA